

V E N D I M
Nr.37, datë 14.10.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Franc Jakova,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datën 25.9.1996 dhe 7.10.1996, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.38 Akti që i përket :

K Ë R K U E S : RAMAZAN SHERJA, i biri i Hasanit, i dtl.1956, lindur e banues në fshatin Korre të rrethit të Elbasanit, me arsim të lartë.

PALE E INTERESUAR : 1. SEKRETARIATI SHTETEROR I PUSHTETIT LOKAL, i përfaqësuar nga Z. Ferdinand Petrela, me autorizim.

2. PREFEKTURA ELBASAN, e përfaqësuar nga prefekti Thanasi Mërkuri dhe me autorizimin e tij edhe prej juristit Pëllumb Barçi.

O B J E K T I :

Shfuqizimi si antikushtetues të Dekretit nr.1429, datë 27.3.1996 “Për shkarkimin e kryetarit të Komunës Funar, kërkuesit Ramazan Sherja

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Me Dekretin nr.1429, datë 27.3.1996, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, kërkuesi Ramazan Sherja është shkarkuar nga detyra e kryetarit të Komunës Funar të rrethit Elbasan, për shkelje të rënda të ligjit.

Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e dekretit të sipërm, duke pretenduar se gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka kryer asnjëherë prej shkeljeve, për të cilat Këshilli i Ministrave ka propozuar dhe Presidenti i Republikës ka dekretuar shkarkimin e tij.

Gjykata Kushtetuese, pas verifikimit të të gjitha fakteve si dhe shpjegimeve që dhanë palët arrin në përfundim, se asnjëra nga shkeljet që i atribuohen kërkuesit nuk qëndron.

Kështu, në kundërshtim me sa parashtrohet në propozimin e Këshillit të Ministrave, nga akt-kontrolli datë 26.10.1995 i Degës së Shërbimit të Kontrollit të Shtetit në Elbasan, del se ky organ nuk ka konstatuar që vetë kërkuesi të ketë kryer ndonjë veprim të kundërligjshëm gjatë ushtrimit të funksioneve të tij. Disa të meta të konstatuara nga ky kontroll i ushtruar për periudhën prill 1994 - tetor 1995, kanë

karakter thjeshtë teknik dhe nuk kanë lidhje me detyrat funksionale të kryetarit të komunës. Për më tepër në këtë akt-kontroll i është bërë një vlerësim pozitiv punës së kësaj komune. Po kështu, edhe vetë Prefekti i Elbasanit deklaroi se nga ana e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit nuk ka pasur ndonjë propozim për marrjen e ndonjë mase kundër kërkuesit.

Vënia në dukje në propozimin e Këshillit Ministrave se kërkuesi ka shpërdoruar ndihmat nuk është e ligjshme dhe çënon të drejtat e tij kushtetuese si qytetar, pasi me vendim të Gjykatës së Kasacionit nr.198, datë 4.11.1994, ai është shpallur i pafajshëm.

Nuk gjen mbështetje gjithashtu as motivimi për shkeljet e procedurave ligjore lidhur me ndarjen e tokës. Si Prefekti i Elbasanit ashtu edhe përfaqësuesi i Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal nuk paraqitën prova në këtë drejtim. Përkundrazi, nga akt-inspektimi datë 26.10.1995, i mbajtur nga inspektoriati rajonal i Elbasanit për veprimtarinë 9/mujore, janar-shtator 1995 të zyrës së përkujdesjes shoqërore të komunës Funar, del se në këtë komunë, në përgjithësi është punuar mirë dhe se për komisionet e ndarjes së tokave të të dy niveleve nuk ngrihet ndonjë problem që ka të bëjë me shkelje të procedurave ligjore nga ana e tyre ose nga kërkuesi si kryetar komune.

Edhe përsa i përket motivit për krijimin e situatave të vështira në punën e administratës së

komunës lidhur me zgjedhjen e kryepleqve, ndryshe nga sa parashtrohet, është e nevojshme të theksohet se kjo çështje nuk ka të bëjë me kërkuesin si kryetar komune, por me këshillin e komunës.

Së fundi, në propozimin për shkarkim, është ngritur si shkelje e rëndë e ligjit edhe mospagimi i arsimtarëve, të emëruar me kontratë në komunën e Funarit, nga

Drejtoria Arsimore e rrethit.

Nga aktet del se edhe për këtë çështje ka vendosur këshilli i komunës dhe jo kërkuesi. Madje këtë vendim me nr.52, datë 31.10.1995, kërkuesi e ka kundërshtuar si të pabazuar në ligj pranë Prefekturës së Elbasanit, me shkresën nr.180/1, datë 3.11.1995.

Në këto raste, si edhe në rastin e mësipërm që i referohet zgjedhjes së kryepleqve, Prefekti, në bazë të paragrafit të tretë të nenit 6 të Ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 “Për Prefekturat”, kishte të drejtë që këto akte të këshillit të komunës që ai i ka quajtur të paligjshme t’ia dërgonte gjykatës, por jo t’i injoronte ose të ngarkonte me përgjegjësi kryetarin e komunës.

Gjykata Kushtetuese bëri verifikime dhe për çështje të tjera që nuk përfshihen në motivacionin e shkarkimit nga detyra të kërkuesit, sidomos për raportet midis Prefektit dhe kryetarit të komunës.

Prefekti, pretendoi se kërkuesi gjatë vitit 1995 si kryetar komune ka nxjerrë rreth 45 vendime dhe urdhëra, por asnjërin prej tyre nuk ia ka dërguar Prefekturës së Elbasanit, për t’i krijuar mundësi prefektit që të ushtrojë mbikqyrjen e ligjshmërisë së këtyre akteve.

Një pretendim i tillë është i pabazuar si në ligj ashtu edhe në fakt.

Në bazë të pikave 3 e 7 të nenit 40 të Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të pushtetit lokal”, komunikimi i akteve, marrja dhe shpërndarja e korrespondencës është në kompetencën e sekretarit të komunës dhe jo të kryetarit ose të këshillit të komunës.

Edhe në fakt, ndryshe nga sa pretendoi prefekti, nga protokoli i akteve del se vendimet e urdhërat e nxjerra i janë dërguar prefekturës.

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 24 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991”Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

Shfuqizimin e Dekretit nr.1429, datë 27.3.1996 të Presidentit të Republikës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot, më datë 14.10.1996